



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 11 dhe 12 të LVL, nenin 37, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, nenin 12, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ; nenin 19 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës (të datës 22.08.2013), si dhe nenit 4, paragrafit 1, pika 1.1 dhe paragrafi 2, pika 2.3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji nr.03/L-139), me qëllim të inicimit të procedurave ligjore për kthimin e këtyre pronave komunës, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Kadastër dhe Banim dhe rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me date 29.11.2016, miraton këtë :

V E N D I M

Për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të disa pronave shoqërore të cilat administrohen nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

I.

APROVOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për **Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik** për pronat shoqërore të cilat administrohen nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP-së), me qëllim të realizimit të interesit publik, ushtrimin e kompetencave të pushtetit lokal në ofrimin e shërbimeve nga lëmi i arsimit, shëndetësisë, sportit, kultures e kompetencave tjera komunale të parapara me LVL dhe Statutin e Komunës.

II.

SHPALLEN Interes i Përgjithshëm Publik këto prona:

1. Njësia Kadastrale P-70403051-02733-0, lloji i njësisë - parcelë, lloji i pronës- shoqërore, zona- rurale, sipërfaqja: 598 m²; vendi i quajtur : “Fshat”, shfrytëzimi aktual i parcelës – tokë ndërtimore- oborr me sipërfaqe prej 302 m² dhe shtëpi – ndërtesë me sipërfaqe prej 296 m², e pronarit : P.Sh. Kooperativa Bujqësore Pogradë, pjesa e pronës 1/1, Zona kadastrale Pogradë.
2. Njësia Kadastrale P-70403039-00166-1, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 329103 m²; vendi i quajtur : “Dushin Dol”, shfrytëzimi aktual i parcelës :

bujqësore-kullosë e klasës 3 e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kombinati i Drurit, sektori i pyjeve Ferizaj, Zona Kadastrale Malishevë, Komuna e Gjilanit.

3. Njësia Kadastrale P-70403008-02561-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 8488 m²; vendi i quajtur : “Llashticë”, shfrytëzimi aktual i parcelës : oborr dhe shtëpi-ndërtesë e pronarit P.Sh. Kooperativa Bujqësore Llashticë, Zona Kadastrale Llashticë,
4. Njësia Kadastrale P-70403008-02564-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 142133 m²; vendi i quajtur : “Llashticë”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-kullosë e kl.5, e pronarit : P.Sh. Kombinati i Drurit- Ferizaj, Sektori i Pyjeve Gjilan , Zona Kadastrale Llashticë,
5. Njësia Kadastrale P-70403007-00265-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 985 m²; vendi i quajtur : “Rosulja”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-arë e kl.4, e pronarit : P.Sh. Koperativa e Përgjithshme Bujqësore, Lladovë, me seli në Zhegër , Zona Kadastrale Lladovë,
6. Njësia Kadastrale P-70403007-00270-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 890 m²; vendi i quajtur : “Rosulja”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-arë e kl.4, e pronarit : P.Sh. Koperativa e Përgjithshme Bujqësore, Lladovë, me seli në Zhegër , Zona Kadastrale Lladovë,
7. Njësia Kadastrale P-70403007-00276-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 1180 m²; vendi i quajtur : “Rosulja”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-arë e kl.4, e pronarit : P.Sh. Koperativa e Përgjithshme Bujqësore, Lladovë, me seli në Zhegër , Zona Kadastrale Lladovë,
8. Njësia Kadastrale P-70403007-00275-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 845 m²; vendi i quajtur : “Rosulja”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-arë e kl.4, e pronarit : P.Sh. Koperativa e Përgjithshme Bujqësore, Lladovë, me seli në Zhegër , Zona Kadastrale Lladovë,
9. Njësia Kadastrale P-70403007-00269-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 795 m²; vendi i quajtur : “Rosulja”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-arë e kl.4, e pronarit : P.Sh. Koperativa e Përgjithshme Bujqësore, Lladovë, me seli në Zhegër , Zona Kadastrale Lladovë,
10. Njësia Kadastrale P-70403007-00266-2, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 940 m²; vendi i quajtur : “Rosulja”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-arë e kl.4, e pronarit : P.Sh. Koperativa e Përgjithshme Bujqësore, Lladovë, me seli në Zhegër , Zona Kadastrale Lladovë,

11. Njësia Kadastrale P-70403007-00282-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 870 m²; vendi i quajtur : “Rosulja”, shfrytëzimi aktual i parcelës : bujqësore-arë e kl.4, e pronarit : P.Sh. Koperativa e Përgjithshme Bujqësore, Lladovë, me seli në Zhegër , Zona Kadastrale Lladovë,
12. Njësia Kadastrale P-70403026—01368-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona: rurale, sipërfaqja: 4660 m²; vendi i quajtur : “Fshat”, shfrytëzimi aktual i parcelës : oborr me sipërfaqe prej 4068 m² dhe shtëpi/ ndërtesë 592 m², e pronarit : P.Sh. Koperativa Bujqësore-Zhegër , Zona Kadastrale Zhegër.

III.

Autorizohet Kryetari i Komunës që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi të inicon tek organet kompetente : Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit , procedurat e parapara ligjore për kthimin e këtyre pronave Komunës së Gjilanit për realizimin e interesit të përgjithshëm publik, ofrimin e shërbimeve dhe ushtrimin e kompetencave të komunës në sferën e arsimit, shëndetësisë, kultures e sportit dhe kompetencave tjera të parapara me ligj.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

V.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-117678
Gjilan, më 29.11.2016

Kryesuesja e KK-Gjilan,

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/

/